

Informacion për të interesuarit

Banka e Shqipërisë fton ofruesit e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e ofrimit të vlerave numizmatike sipas listës bashkëlidhur këtij njoftimi.

Pranimi i vlerave numizmatike bëhet në Sportelin e Arkës Numizmatike për Shitje (Godina Qendrore e Bankës). Vlerat numizmatike të ofruara për shitje duhet të shoqërohen me pasaportën e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës, ku sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi paraqitja e tyre është e nevojshme. Vlerat numizmatike të ofruara për shitje shoqërohen me foto të vlerës numizmatike, si dhe me një dokument identifikimi apo dokument tjetër të njohur ligjërisht që vërteton identitetin e ofruesit.

Çdo ofrues do të pajiset me një dokument që vërteton dorëzimin e vlerave pranë sportelit të Arkës Numizmatike të Bankës.

Çmimi i secilës vlerë numizmatike të paraqitur nga ofruesit do të përcaktohet nga Komisioni për vlerësimin e vlerave numizmatike, në përputhje me rregulloret e Bankës së Shqipërisë dhe në vijimësi do të bëhen njoftimet përkatëse.